



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

DREJTORIA BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI PERSONELIT

SHPLLJE PËR POZICION TË LIRË

Në zbatim të ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të VKM nr. 243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, në Vendimin nr.04, prot.325 datë 09.01.2025 “Për ndryshimin e strukturës dhe rregullores së Bashkisë Durrës”, si dhe në Urdhrin nr.191 prot.8347, date 08.07.2025 “Për shpalljen e konkurimit për pozicion të lirë”, Bashkia Durrës shpall konkurimin për këtë pozicion:

Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve pranë Drejtorisë Ligjore

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Afati për dorëzimin e dokumenteve për: LËVIZJE PARALELE

24.07.2025

Afati për dorëzimin e dokumenteve: PËR PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

28.07.2025

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

- Të zbatojë detyrat e ngarkuara nga eprorët si dhe urdhrat e dala nga titullari.
- Të kryejë aplikimin online për regjistrim, apo informacion në lidhje me evidentimin e pronave të bashkisë me institucionin e DVASHK-së, sipas matjeve në terren dhe konfigurimit hartografik.
- Të hartojë shkresa me institucionet shtetërore, që lidhen me regjistrimin e pronave të bashkisë si dhe të mbajë korespondencë për problemet që kanë personar fizikë apo juridikë, publik e privat që kërkojnë konfirmimin në lidhje me pronat në pronësi apo përdorim të bashkisë.
- Të regjistrojë në sistemin elektronik pronat e bashkisë si dhe ato të ish komunave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Të kryejë azhurnimin e të gjithë pronave si të atyre që shtohen dhe të atyre që hiqen si rezultat i një akti administrativ apo ligjor.

-Të bashkëpunojë me njësitë administrative me qëllim azhurnimin e listës paraprake të pronave të miratuara me VKM , deri në miratimin e listës përfundimtare në Këshillin e Ministrave.

I. LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1. Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Arsimi: *Topograf, Gjeodet,*

- a) të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IV-2;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- d) të ketë eksperiencë 5 vjet dhe notë mesatare mbi 8.5;
- e) të ketë certifikime, specializime, trajnime, projekte në fushën e përkatëse
- f) të ketë njohuri te gjuhës angleze
- g) të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

2. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b) Fotokopje të diplomës dhe listes se notave.Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Fotokopje të kartes se identitetit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, 2000 Durrës

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: 24.07.2025

3. Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **25.07.2025**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Kodin e Procedurave Administrative

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Ligji nr. 44/2014 datë 24.4.2014 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

Ligji 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Ligji nr.8743 dt.22.02.2001 “Për pronat e paluejtshme të shtetit”, i ndryshuar.

Ligji nr.8744 dt.22.02.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

VKM nr.500 dt.14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluejtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, indryshuar.

Ligji nr.20/2020 “Për përfundimin proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (40 pikë)

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencës, trajnimit, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

b) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (60 pikë)

- ✓ Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- ✓ Eksperiencën e tyre të mëparshme;

- ✓ Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail).

II. PËR PRANIMIN NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

Vetëm në rast se pozicioni në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Bashkisë.

Konkurimi është i hapur për pranimin në shërbimin civil në **KATEGORINË EKZEKUTIVE**, sipas parashikimeve të nenit 22 të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë **KËRKESAT E PËRGJITHSHME** për pranimin në Shërbimin Civil në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar si më poshtë:

- të jetë shtetas shqiptar;
- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;

I. TË DHËNAT E POZICIONIT TË PUNËS

Emërtesa e pozicionit: Specialist

Institucioni: Bashkia Durrës

Drejtoria: Drejtoria Ligore

Spektori: Spektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve

Raporton tek: Përgjegjësi i spektorit

I. MISIONI

Sektori i pronave publike dhe menaxhimit të asetëve është përgjegjës për mirëadministrimin e cdo çështje që lidhet me identifikimin , regjistrimin dhe inventarizimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë , aplikimit për regjistrim në ASHK të pronave të bashkisë dhe të institucioneve , ndërmarrjeve buxhetore dhe jobuxhetore , në varësi të bashkisë Durrës.Gjithashtu sektori i pronave publike dhe menaxhimit të asetëve harton dhe ndjek kontratat që kanë të bëjnë me dhënien në gëzim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme pronë e bashkisë ,si dhe ndjek të gjitha procedurat ligjore nëpërmjet këshillit bashkiak për dhënien në përdorim të pasurive që kanë sipërfaqe më shumë se 200 m2 të cilat janë në pronësi të bashkisë apo në inventar të ndërmarrjeve apo institucioneve të varësisë.

II. DETYRAT KRYESORE

- a) - Të zbatojë detyrat e ngarkuara nga eprorët si dhe urdhrat e dala nga titullari.
- b) -Të kryejë aplikimin online për regjistrim, apo informacion në lidhje me evidentimin e pronave të bashkisë me institucionin e DVASHK-së,sipas matjeve në terren dhe konfigurimit hartografik.
- c) -Të hartojë shkresa me institucionet shtetërore, që lidhen me regjistrimin e pronave të bashkisë si dhe të mbajë korespondencë për problemet që kanë personar fizikë apo juridikë, publik e privat që kërkojnë konfirmimin në lidhje me pronat në pronësi apo përdorim të bashkisë.
- d) -Të regjistrojë në sistemin elektronik pronat e bashkisë si dhe ato të ish komunave të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- e) -Të kryejë azhurnimin e të gjithë pronave si të atyre që shtohen dhe të atyre që hiqen si rezultat i një akti administrativ apo ligjor.
- f) -Të bashkëpunojë me njësitë administrative me qëllim azhurnimin e listës paraprake të pronave të miratuara me VKM , deri në miratimin e listës përfundimtare në Këshillin e Ministrave.

PËRGJEGJËSITË KRYESORE LIDHUR ME:

A. PLANIFIKIMIN (nëse ka)

Planifikon orarin e punës duke bërë ndarjen e duhur të kohës midis aktiviteteve që duhet të permbushë.

B. DETYRAT TEKNIKE

Jep përgjigje ligjore dhe teknike për problemet specifike që mbulon sipas detyrave që i ngarkohen brenda sektorit, si dhe përgatit propozime lidhur me trajtimin e çështjeve të ndryshme me karakter profesional dhe teknik, sipas fushave që mbulon sektori

III. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Raporton pranë Përgjegjesit të sektorit mosmarrëveshje të mundshme, dhe përpiqet t'i zgjidhë ato, duke ndjekur udhëzimet përkatëse.

IV. MJEDISI MENAXHERIAL

Raporton tek eprori direkt

V. MBIKQYERJA

Specialisti mbikëqyret për çështjet e caktuara nga eprori direkt

VI. STAFI NËN VARËSI (*s'ka*)

VII. KUSHTET E PUNËS

Në përputhje me parimet e përgjithshme të kushteve të punës të përcaktuara në rregulloren e Institucionit

KËRKESAT E POSAÇME

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimi: (*Master Shkencor/DND*) Topograf, Gjeodet,

Tjetër:

- Të ketë eksperiencë 5 vjet dhe notë mesatare mbi 8.5.
- Të ketë certifikime, specializime, trajnime, projekte në fushën e përkatëse
- Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze, preferohet njohja e një gjuhe të dytë të BE.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1. Dokumentet, mënyra dhe afati i dorëzimit

- a) Letërmotivimi për aplikim në vendin vakant;
- b) Nje kopje jetëshkrimi;
- c) Një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit;
- d) Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- e) Fotokopje e listës së notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, atëherë aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- f) Nje kopje e librezës së punës e plotësuar;
- g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- h) Certifikata të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- i) Dëshmi të njohjes së një gjuhe të huaj;
- j) Fotokopje e kartes së identitetit.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, 2000 Durrës

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve për pranimin nga jashtë shërbimit civil duhet të bëhet brenda datës: 28.07.2025

2. Rezultatet për fazën e seleksionimit paraprak

Në datën **30.07.2025**, Bashkia Durrës do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën për konkurimin për këto pozicione, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

3. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Kodin e Procedurave Administrative

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Ligji nr. 44/2014 datë 24.4.2014 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Ligjin nr. 9131 dt. 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

Ligji 139 dt. 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Ligji nr.8743 dt.22.02.2001 “Për pronat e paluejtshme të shtetit”, i ndryshuar.

Ligji nr.8744 dt.22.02.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

VKM nr.500 dt.14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluejtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar.

Ligji nr.20/2020 “Për përfundimin proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

4. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

a) Vlerësimi i dokumentacionit të dorëzuar: (15 pikë)

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencës, trajnimit, kualifikimit e lidhura me fushën përkatëse, si dhe vlerësimet positive.

b) Vlerësimi me shkrim: (60 pikë)

c) Vlerësimi gjatë intervistës së strukturuar me gojë: (25 pikë)

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

5. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Durrës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail).